

URDHËR
Nr.493, datë 6.10.2011

PËR SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT DYTË, “MASTER PROFESIONAL”, PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, BUJANOVCI DHE MEDVEGJA NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, VITI AKADEMIK 2011-2012

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 4 të vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, “Master profesional” për vitin akademik 2011-2012”,

URDHËROJ:

1. Shpërndarjen e kuotave të pranimit, për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë të Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës për programet e studimit të ciklit të dytë, “Master profesional”, për vitin akademik 2011-2012, të cilat pasqyrohen, në total për çdo program studimi, në kolonën E të tabelës nr.1, të vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve master profesional, për vitin akademik 2011-2012, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Administrimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e kandidatëve nga Republika e Kosovës, si dhe i kandidatëve shqiptarë të Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës bëhet nga institucionet publike të arsimit të lartë (IAL) pritëse, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga vetë IAL-të publike, sipas kritereve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.

3. Kandidatët fitues, sipas programeve të ndryshme të studimit, midis aplikantëve nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatëve shqiptarë të Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, shpallen në përputhje me kuotat e përcaktuara sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë, deri në datë 30.10.2011, të dërgojnë kuotat e parealizuara nga regjistrimet e kandidatëve fitues, në mënyrë që Ministria e Arsimit dhe Shkencës të bëjë rishpërndarjen e tyre.

5. Ngarkohen Zëvendësministri, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj